



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 90, datë 28.04.2022

PËR
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “BURSA SHQIPTARE E
TITUJVE ALSE” SH.A., ME KËRKESAT E LIGJIT NR. 62/2020 “PËR TREGJET E
KAPITALIT”, SI DHE MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË NDRYSHUARA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 147 dhe nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Ligji nr.62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, në nenin 377, pika 1, parashikon se: “Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me kusht që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtaten me kërkesat e këtij ligji”.

Për të vijuar veprimtarinë për të cilën është licencuar, shoqëria “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a., duhet të përshtatet me kërkesat dhe kushtet e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Shoqëria “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a., aktualisht mban licencën nr. 2, datë 03.07.2017, lëshuar në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, i shfuqizuar. Licenca që mban shoqëria, nga pikëpamja e veprimtarisë është e njëjtë me veprimtarinë e Bursës të parashikuar në Seksionin III, të Kreut V, të Ligjit nr. 62/2020.

Me qëllim përshtatjen e veprimtarisë, shoqëria “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a., ka rishikuar dhe përshtatur rregulloren e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE, rregulloren e monitorimit, mbikëqyrjes dhe penaliteteve në Bursën ALSE, si dhe aktet e tjera të saj.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a., për veprimtarinë e Bursës, sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.**
- 2. Miratimin e rregullores së ndryshuar të Bursës Shqiptare të Titujve, sipas tekstit bashkëlidhur.**
- 3. Miratimin e rregullores së ndryshuar të monitorimit, mbikëqyrjes dhe penalteteve në Bursën ALSE, sipas tekstit bashkëlidhur.**
- 4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE